



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 153, datë 29.03.2023

**PËR
KOMANDIMIN E GJYQTARES {...} NË POZICIONIN E NËPUNËSIT
PËRGJEGJËS PËR VLERËSIMIN, NË NJËSINË E VLERËSIMIT ETIK DHE
PROFESIONAL TË GJYQTARËVE, PRANË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 53, 54 pika 5 dhe 6 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 44, datë 27.01.2023 “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
2. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon në data 11.04.2023.
3. Përfundimin e menjëhershëm të gjyqtares {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR